

Bazuar ne nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenin 8 të Ligjit nr. 04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 23 qershor 2015, miratoi:

## **Rregullore për përcaktimin e strukturës së primit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i strukturës së primit, që siguruksi duhet të zbatojë në caktimin e primit për sigurimin e detyrueshëm, si dhe procedurat dhe afatet për miratim nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
2. Kjo rregullore është e aplikueshme për siguruksit që janë të licencuar nga BQK-ja për shitjen e produktit për sigurim të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe Byronë Kosovare të Sigurimeve sa i përket sigurimit kufitar të autopërgjegjësisë.

### **Neni 2**

#### **Përkufizime**

1. Të gjitha termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet siç janë përcaktuar me nenin 2 të Ligjit nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia (në vijim: Ligji për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia) dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje.
  - 1.1. **Primi i rrezikut** – nënkupton pjesën e primit të sigurimit të vlerësuar:
    - 1.1.1. Për të mbuluar dëmet e përcaktuara në kontratën e sigurimit dhe shpenzimet për trajtimin e këtyre dëmeve, dhe
    - 1.1.2. Për të financuar kontributin e siguruksve në fondin e kompensimit, sipas parashikimeve të nenit 32 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia.
  - 1.2. **Ngarkesa mbi primin e rrezikut** - nënkupton fitimin e vlerësuar nga siguruksit dhe të gjitha kostot e lidhura me policën e sigurimit, me përjashtim të dëmeve dhe kontributit për fondin e kompensimit.
  - 1.3. **Aktuari** – nënkupton personin e autorizuar nga siguruksi, i cili duhet të jetë i aprovuar nga BQK-ja.

### **Neni 3**

#### **Bazat e të dhënave për hartimin e tabelave të primit të rrezikut**

1. Në hartimin e tabelave të primeve të rrezikut, aktuari duhet të marrë parasysh një bazë të gjerë të të dhënave statistikore të tregut për një periudhë që përfshin të paktën 5 vitet e fundit. Baza e të dhënave duhet të përfshijë edhe të dhënat për dëmet e regjistruara për llogari të fondit të kompensimit në periudhën që merret në shqyrtim.
2. Baza e të dhënave statistikore të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbajë detajet si në vijim:
  - 2.1. kategoritë e automjeteve për policat dhe dëmet;
  - 2.2. kohëzgjatjen e mbulesës siguruese;
  - 2.3. lloji i dëmit (material dhe jo material);
  - 2.4. shtrirja territoriale e policave të lëshuara/dëmeve të ndodhura;
  - 2.5. përfshirja e shpenzimeve të procesit gjyqësor në trajtimin dhe vlerësimin e dëmit;
  - 2.6. elemente të tjera që mund të përdoren në procesin e vlerësimit aktuarial të primit të rrezikut.
3. Aktuari harton tabelat dhe kryen vlerësimin e primit të rrezikut sipas metodave aktuaristike që përfshijnë edhe analizën e ndikimit të faktorëve ekonomikë dhe financiarë të përgjithshëm, apo të lidhur në veçanti me produktin.

### **Neni 4**

#### **Raporti aktuarial**

1. Tabelat e primeve të rrezikut të përcaktuara nga aktuari shoqërohen me një raport aktuarial që paraqet në mënyrë të detajuar:
  - 1.1. vlerësime mbi profilin e rrezikut të çdo produkti dhe tendencat e shfaqura;
  - 1.2. vlerësime për dëme të mëdha dhe tendencat;
  - 1.3. metodën statistikore të përdorur në llogaritjen e dëmit mesatar të rregulluar;
  - 1.4. frekuencën e dëmeve të rregulluara;
  - 1.5. normën e pritshme të inflacionit të përgjithshëm dhe atij të produktit;
  - 1.6. koeficientin e pritshëm për fondin e kompensimit;
  - 1.7. metodat statistikore dhe aktuariale të përdorura në vlerësimin e çdo elementi tjetër të primit të rrezikut, përfshirë këtu gjykimet mbi efektin material dhe jo material;

### **Neni 5**

#### **Miratimi i tabelave të primit të rrezikut nga BQK**

1. Siguruesi dorëzon tek BQK-ja, raportin aktuarial bashkë me tabelat e primeve të rrezikut.
2. BQK, pas pranimit të raportit aktuarial bashkë me tabelat e primeve të rrezikut, brenda 30 ditësh, merr vendim për miratimin apo refuzimin e tyre. Nëse miratohen, ato do të

zbatohen nga siguruesi për një periudhë të paktën 1 (një) vjeçare, përveç nëse siguruesi dokumenton se kanë nevojë për rishikimin dhe ndryshimin e tyre.

## **Neni 6**

### **Llogaritja e primit të sigurimit nga Siguruesi**

1. Tabelat e primit të rrezikut të miratuara nga BQK-ja shërbejnë si bazë për hartimin e tabelave të primeve të siguruesit.
2. Primi i sigurimit llogaritet si shumë e primit të rrezikut plus ngarkesa mbi primin e rrezikut.
3. Ngarkesa mbi primin e rrezikut përcaktohet nga siguruesi, bazuar në tabelat e miratuara të primit të rrezikut, në planin e saj të biznesit për produktin dhe në vlerësimet e aktuarit të saj të autorizuar.
4. Niveli i ngarkesës mbi primin e rrezikut nuk duhet të kalojë masën 30% të primit të sigurimit.

## **Neni 7**

### **Miratimi i tabelës së primeve të sigurimit**

1. Siguruesit duhet të dorëzojnë për aprovim në BQK-në, në afat së paku gjashtëdhjetë (60) ditë para zbatimit, kushtet e sigurimit si dhe bazën teknike të përdorur për llogaritjen e primit.
2. Kur BQK-ja konstaton se kushtet e sigurimit dhe bazat teknike janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, dhe parimet e aktuaristikës, në afatin prej (30) ditësh e njofton siguruesin për zbatimin e tyre. Nëse BQK-ja nuk përgjigjet lidhur me aprovimin apo refuzimin brenda tridhjetë (30) ditësh, konsiderohet se kushtet dhe tarifat e sigurimit janë aprovuar.
3. Tabelat e primeve të sigurimit duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje dhe të shoqërohen me raportin e aktuarit të autorizuar në lidhje me ngarkesën mbi primin e rrezikut.
4. Kur BQK-ja konstaton se kushtet e primit dhe bazat teknike nuk janë në përputhje me ligjin dhe këtë rregullore, kërkon që siguruesi t'i ndryshojë ato.
5. Përfshirja e sistemit bonus malus në përlllogaritjen e primit të sigurimit duhet të behet në pajtim me rregulloren në fuqi për implementimin e sistemit bonus malus.
6. Siguruesit kanë të drejtë të aplikojnë një herë gjatë një viti për ndryshimin e primeve të sigurimit, përveç nëse siguruesit dokumentojnë se kanë nevojë për rishikimin dhe ndryshimin e tyre.
7. Pavarësisht nga paragrafi 6 i këtij neni, BQK-ja sipas vlerësimit të saj ka të drejtë të kërkojë nga siguruesit që t'i ndryshojnë primet e sigurimit në çdo kohë.
8. Siguruesi zbaton tabelat e primeve të sigurimit vetëm pas miratimit nga BQK-ja dhe njofton BQK-në për datën e fillimit të zbatimit të tyre. Nëse BQK-ja nuk përgjigjet

lidhur me aprovimin apo refuzimin e kërkesës brenda 30 ditësh konsiderohet se kushtet dhe tarifatat e sigurimit janë aprovuar.

9. Tabelat e primeve të sigurimeve të miratuara nga BQK janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga siguruesit për një periudhë të paktën 1-vjeçare nga data e miratimit, përveç nëse siguruesit dokumentojnë se kanë nevojë për rishikimin dhe ndryshimin e tyre, ose kur BQK-ja kërkon rishikimin e tyre.

#### **Neni 8**

##### **Sigurimi kufitar i autopërgjegjesisë**

1. Me kërkesë të BQK-së, Byroja Kosovare e Sigurimit në emër të siguruesve, brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, janë të obliguar që të dërgojnë në BQK për aprovim, tarifën e primit për sigurimin kufitar të autopërgjegjesisë.
2. Në rast se BQK-ja vlerëson se kushtet e primit dhe bazat teknike nuk janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, atëherë BQK-ja do të vendos shumën minimale apo maksimale të primit për sigurimin kufitar të autopërgjegjesisë apo kufirin brenda të cilit primi për sigurimin kufitar të autopërgjegjesisë duhet të jetë.

#### **Neni 9**

##### **Dispozita kalimtare**

1. Primet aktuale për produktin e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia (MTPL e brendshme), mbeten të pandryshuara, deri sa BQK-ja të nxjerrë vlerësim aktuarial mbi produktin e autopërgjegjesisë, për tregun e sigurimeve.
2. Pas nxjerrjes së vlerësimit aktuarial, sipas paragrafit 1 të këtij neni, BQK-ja njofton siguruesit për këtë vlerësim, pas të cilit siguruesit duhet të bëjnë kërkesë për aprovimin e primeve, sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 10**

##### **Masat ndëshkimore**

Në rast moszbatimi të dispozitave të kësaj Rregulloreje, BQK-ja do të ndërmerr masa sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

#### **Neni 11**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 24 qershor 2015.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore

---

**Bedri Peci**